



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 06, datë 12.04.2017

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NËN STACIONI I RI DHE 110/10 KV DHE LINJA E TRANSMETIMIT TË TENSIONIT TË LARTË 110 KV”, ME VENDNDODHJE PRANË UZINËS SË FERROKROMIT ELBASAN

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Albania Energy Supplier” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Nën stacioni i ri dhe 110/10 kV dhe Linja e transmetimit të tensionit të lartë 110 kv”, me vendndodhje pranë Uzinës së Ferrokromit Elbasan, me subjekt zhvillues “Albania Energy Supplier” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Elbasan.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN

Egjeimeri



SEKRETAR I KKT

LËDIA TOTIA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

